



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet më të fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Të mërkurën, më 10 maj, dëshmitari i katërt i thirrur nga Zyra e Prokurorit të Specializuar në çështjen gjyqësore Hashim Thaçi dhe të tjerët filloi dhënien e dëshmisë, e cila deri më tani është kryer në seancë private.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 8 maj, ekipet e Mbrojtjes të Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit dorëzuan versionin e redaktuar publik të dosjeve paraprake të tyre, të cilat mund t'i gjeni në faqen e internetit të DHSK-së.

Sipas Rregullores, dosja paraprake e Mbrojtjes mund të tregojë në pika të përgjithshme llojin e argumenteve mbrojtëse të të akuzuarit, akuzat dhe aspektet që i akuzuari i kundërshton dhe listën e dëshmitarëve që Mbrojtja synon t'i thërrasë.

Në çështjen gjyqësore Salih Mustafa, versioni i redaktuar publik i dosjes së apelit të Mbrojtjes është në dispozicion në faqen e internetit të DHSK-së. Versioni origjinal i dosjes u dorëzua më 24 prill. Dosja e apelit është një dokument në të cilin Mbrojtja përshkruan të gjitha argumentet dhe precedentët gjyqësorë në mbështetje të apelit kundër aktgjyqimit.

Hapi i ardhshëm në procesin e apelit është që Prokuroria dhe Mbrojtësi i Viktimave t'u përgjigjen argumenteve të Mbrojtjes. Më 5 maj 2023, Paneli i Gjykatës së Apelit miratoi pjesërisht kërkesën e Prokurorisë dhe të Mbrojtësit të Viktimave për zgjatjen e afatit për dorëzimin e dosjeve të tyre në përgjigje ndaj dosjes së apelit të Mbrojtjes deri më 5 qershor 2023.

Në çështjen gjyqësore Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj, sikurse u njoftua javën e kaluar, që të dy, Gucati dhe Haradinaj i janë drejtuar Dhomës së Gjykatës Supreme të DHSK-së me kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në lidhje me aktgjykimin e Panelit të Gjykatës së Apelit në këtë çështje. Më 8 maj, Paneli i Gjykatës Supreme urdhëroi Mbrojtjen e Haradinajt që ta ridorëzojë kërkesën e vet, pasi konstatoi se ishte tejkaluar numri i lejuar i fjalëve. Mbrojtja e Haradinajt e ridorëzoi kërkesën më 10 maj.

Sa u përket hapave të ardhshëm, Paneli i Gjykatës Supreme ka urdhëruar Prokurorinë që të dorëzojë përgjigje ndaj parashtrimeve të Mbrojtjes në lidhje me mbrojtjen e ligjshmërisë brenda 60 ditësh dhe Mbrojtja do të ketë 30 ditë pas kësaj që t'i kundërpërgjigjet Prokurorisë.

Në gjykimin e Pjetër Shalës, Paneli i Gjykatës së Apelit mori në shqyrtim aspektin e pranueshmërisë së deklaratave të mëparshme të dhëna nga i akuzuari në 2016 dhe 2019, si dhe dokumente të tjera përkatëse. Paneli miratoi pjesërisht njëren prej pikave të apelit të Mbrojtjes, duke lënë në fuqi vendimin e Trupit Gjykses për t'i konsideruar të pranueshme deklaratat e mëparshme përkatëse.

1





KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Informim javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**  
N°18/2023  
Hagë, 11/05/2023

## **Pyetje nga gazetarët**

